



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Godina ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 042268142

Nr. 1406 Prot.

Tiranë, më 19.07.2017

V E N D I M

Nr. 172, datë 19/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016 deri në momentin e verifikimit"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e veprimeve administrative gjatë administrimit të shërbimit civil në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016, që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 1, datë 13.01.2017, "Për verifikimin e zbatimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016 dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative në fushën e administrimit të shërbimit civil të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të kryera prej datës 20.05.2016 e në vazhdim", mbi bazën e Programit të Verifikimit nr. 18/1 prot., datë 13.01.2017, ka vendosur kryerjen e procesit të verifikimit të veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, prej datës 20.05.2016, (e cila ka lidhje me momentin e përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil) deri në momentin e procesit të verifikimit, Janar 2017.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nga grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Për realizimin e këtij procesi, fillimisht u njoftua institucioni me shkresën nr. 18/2, datë 13.01.2017, "Njoftim për fillimin e verifikimit", dhe më tej u administruan dokumentet si më poshtë:

- Struktura dhe organika e institucionit e miratuar me urdhrin nr. 119, datë 10.03.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, të ndryshuar me urdhrin nr. 131, datë 23.08.2016, të Kryeministrit, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 119, datë 10.03.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”;
- Listëpagesat e punonjësve të institucionit për periudhën Maj 2016 – Janar 2017;
- Për emërimet e reja në pozicionet e shërbimit civil u administruan aktet e emërimit;
- Për nëpunësit civilë, ndaj të cilëve janë marrë masa disiplinore u administruan aktet administrative që materializojnë procedurën.
- Për nëpunësit civilë që kanë përfunduar marrëdhëniet e punës, u administruan aktet për përfundimin e marrëdhënieve të punës me institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është një institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili funksionon mbi bazën e strukturës së miratuar me urdhrin nr. 119, datë 10.03.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, i ndryshuar me urdhrin nr. 131, datë 23.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”. Sipas kësaj strukture, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit organizohet në nivel qendror nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale në 12 Qarqet e vendit dhe konkretisht në Qarqet Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Berat, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Lezhë. Sipas strukturës së miratuar, në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit numri total i pozicioneve të punës është **421**, nga të cilat **401 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil**.

Duke analizuar me radhë problematikat e evidentuara gjatë inspektimit, rezulton se, **20 pozicione pune**, pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi emërimi i punonjësve në këto pozicione pune është realizuar nëpërmjet emërimeve të përkohshme ose kontratave të përkohshme, duke mos zbatuar procedurën e konkurrencës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se 8 prej këtyre rasteve janë konstatuar në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes së mëparshme, të organizuar nga Komisioneri, e konkretisht bëhet fjalë për punonjësit ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** . Me vendimin nr. 100, datë 13.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”, Komisioneri ka kërkuar revokimin e akteve të emërimit.

Në momentin e kryerjes së verifikimit, rezulton se këta punonjës vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre në këtë institucion, pasi aktet e emërimit nuk janë revokuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU. Për këtë arsye me vendimin nr. 56 datë 21.03.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është kërkuar shfuqizimi i akteve të emërimit për këta punonjës.

Ndërkohë rezulton se, për periudhën e verifikimit 20.05.2016 – 11.01.2017, janë kryer **12 emërime të reja**, pa respektuar procedurën e rekrutimit të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për

nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

a) Punonjës të emëruar me akte emërimi të përkohshëm, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit:

- *****, emëruar me aktin nr. 4307, datë 18.10.2016, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- *****, emëruar me aktin nr. 5345, datë 15.12.2016, në pozicionin e punës “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- *****, emëruar me aktin nr. 4183, datë 12.10.2016, në pozicionin e punës “*Inspektor*”, në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- *****, emëruar me aktin nr. 122, datë 11.01.2017, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- *****, emëruar me aktin nr. 3783, datë 15.09.2016, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- *****, emëruar me aktin nr. 1854, datë 16.05.2016, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- *****, emëruar me aktin nr. 5551, datë 04.01.2017, në pozicionin e punës “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë;
- *****, emëruar me aktin nr. 123, datë 11.01.2017, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Elbasan;
- *****, emëruar me aktin nr. 1994, datë 26.05.2016, në pozicionin e punës “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë;
- *****, emëruar me aktin nr. 5389, datë 19.12.2016, në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Berat.
- *****, emëruar me aktin nr. 3935, datë 28.09.2016, në pozicionin e punës “*Drejtor*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë.

b) Punonjës i emëruar me akt emërimi të përkohshëm, të nxjerrë nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave:

- *****, emëruar me aktin nr. 2458/2, datë 04.04.2016, në pozicionin e punës “*Drejtor*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë;

Emërimi i punonjësve të mësipërm, në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, është bërë në kundërshtim me kërkesat e neneve 20, 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë se emërimi në pozicionet e nivelit ekzekutiv realizohet nëpërmjet lëvizjes paralele ose procedurës së konkurrimit të hapur, ndërsa për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, emërimi realizohet nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë. Këto procedura për institucionin në verifikim, realizohen nga njësia përgjegjëse, që në këtë rast është Departamenti i Administratës Publike.

Mosrespektimi i procedurave të mësipërme, në zbatim të nenit 108, germa “a”, pika “ii”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, passjellin pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e mësipërm si dhe në vështrim të nenit 109, pika “a” dhe “b”, të ligjit në fjalë, për shkelje të procedurës i bën këto akte të paligjshme.

Në këto rrethana, në kuptim të nenit 110, pika 1, të ligjit të sipërcituar, aktet e emërimit për **12 punonjësit** e mësipërm, si akte absolutisht të pavlefshme, nuk mund të sjellin pasoja juridike, pavarësisht faktit nëse ato janë konstatuar si të tilla apo jo. Në zbatim të nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vetë organet publike, të cilat kanë nxjerrë aktin administrativ, që në rastin konkret për **11 raste** paraqitet Drejtori i Përgjithshëm i AKU dhe për **1 rast** paraqitet Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, duhet të konstatojnë ekzistencën në këto veprime administrative të rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit të sipërcituar. Njësia përgjegjëse në këtë proces duhet të drejtojë procesin e anulimit të akteve të emërimit për 12 rastet e mësipërme.

Në vijim të analizës së shkeljeve të ndërmarra, nisur nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e administruar, rezultoi se për periudhën e verifikimit janë kryer transferime të përkohshme, në kundërshtim me kërkesat e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konkretisht bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë:

1. ******, emëruar me aktin nr. 959, datë 24.07.2014, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë. Me urdhër të brendshëm nr. 1809, datë 11.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan.
2. ******, emëruar me aktin nr. 981, datë 25.07.2014, në kuadër të ristrukturimit të institucionit në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë. Me urdhër të brendshëm nr. 6, datë 08.01.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, kjo punonjëse është transferuar, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan.
3. ******, emëruar me aktin nr. 793, datë 25.07.2014, në kuadër të ristrukturimit të institucionit, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë. Me urdhrin nr. 1920 prot., datë 20.05.2016, të Drejtorit të

Përgjithshëm të AKU, është transferuar përkohësisht, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan.

4. *****, emëruar me aktin nr. 998, datë 30.07.2014, në kuadër të ristrukturimit të institucionit në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier. Me urdhrin nr. 3457 prot., datë 22.08.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm ky punonjës është transferuar, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Durrës.
5. *****, emëruar me aktin nr. 5/4, datë 25.02.2014, në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë. Me urdhrin nr. 3438 prot., datë 18.08.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm ky punonjës është transferuar, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë.
6. *****, emëruar me aktin nr. 156, datë 14.01.2015, të DAP, në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Berat. Me urdhrin e brendshëm nr. 1600 prot., datë 28.04.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar përkohësisht, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
7. *****, emëruar me aktin nr. 3688/5, datë 18.11.2015, të DAP, në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Gjirokastrë. Me urdhrin e brendshëm nr. 5 prot., datë 08.01.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar përkohësisht, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë.
8. *****, emëruar me aktin nr. 947, datë 24.07.2014, në kuadër të ristrukturimit të institucionit në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU. Me urdhrin nr. 1680 prot., datë 06.05.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, ky punonjës është transferuar përkohësisht, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së institucionit qendror dhe Drejtorive Rajonale, rezultoi se për punonjësit e mësipërm, pagesa për pozicionin e punës kryhet nga institucioni ku ata janë emëruar nga njësia përgjegjëse (DAP), ndërsa listëprezenca hartohet nga institucioni, ku sipas urdhrin të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm janë caktuar të ushtrojnë detyrën e tyre.

Në kuptim të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në interes të institucionit, me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar ose të njësisë së burimeve njerëzore, duke përcaktuar dhe kohëzgjatjen e këtij transferimi, i cili duhet të jetë deri në 6 muaj gjatë 2 viteve. Nga ana tjetër, në kuptim të pikës 5, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë*”, vendimi për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil duhet të miratohet nga njësia përgjegjëse, në këtë rast nga Departamenti i Administratës Publike. Nga verifikimi i dosjes personale të nëpunësve civilë të sipërpërmendur dhe nga komunikimi me njësisë e burimeve njerëzore, rezultoi se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk i është drejtuar njësisë përgjegjëse, DAP, për të kërkuar miratimin në lidhje me procedurat e mësipërme.

Mosrespektimi i procedurës së përcaktuar në dispozitat ligjore të mësipërme, i klasifikon aktet e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për transferimin e përkohshëm për **8 punonjësit** e mësipërm, në kuptim të nenit 108, germa “a”, pika “ii”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si akte absolutisht të pavlefshme, të cilat nuk sjellin pasoja juridike. Në këto kushte, në zbatim të nenit 111, të ligjit të sipërcituar, vetë organi publik, që në rastin konkret paraqitet Drejtori i Përgjithshëm i AKU, duhet të konstatojë ekzistencën e elementëve të pavlefshmërisë në këto akte administrative, duke vendosur anulimin e tyre si akte absolutisht të pavlefshme.

Gjatë procesit të verifikimit, janë konstatuar edhe disa parregullsi në veprimet administrative të kryera nga institucioni Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në lidhje me punonjësit ***** dhe *****, të cilat konsistojnë si më poshtë:

Për punonjësin ***** me aktin nr. 5674/2, datë 10.10.2016, të Departamentit të Administratës Publike, është miratuar transferimi i përkohshëm deri në 6 muaj në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU*”. Procedura e transferimit të përkohshëm për këtë punonjës, është kryer sipas përcaktimeve të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Kreut I, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, rezulton se ky punonjës plotëson kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit të punës, pasi disponon dhe diplomë të arsimit të lartë, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në momentin e kryerjes së verifikimit (Janar 2017), rezulton se titullari i këtij institucioni, me urdhrin e brendshëm nr. 4127/2, datë 13.10.2016, për nevojat e institucionit ka ngarkuar përkohësisht punonjësin ***** me detyrën e *Përgjegjësit të Sektorit të Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU*, pasi punonjësja ***** e cila ka qenë e emëruar më parë në këtë pozicion, me aktin nr. 230/5, datë 01.04.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, është pezulluar nga shërbimi civil për një afat 2-vjeçar.

Gjatë procesit të përpunimit të të dhënave, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është protokolluar shkresa me nr. 89, datë 09.02.2017, e kërkueses ***** nga përmbajtja e së cilës, rezulton se me aktin nr. 7230/1, datë 02.12.2016, të Departamentit të Administratës Publike, për këtë punonjëse është vendosur rikthimi në pozicionin ku ajo ka qenë e emëruar. Në lidhje me këtë akt, nëpunësja ***** ka kërkuar zbatimin e këtij akti, i cili deri më datë 07.02.2017, figuron të mos jetë vënë në zbatim nga institucioni në hetim.

Nga verifikimi i kryer në institucion, në datën 09.03.2017 (*për të cilin është mbajtur procesverbali përkatës*), rezulton se me urdhrin nr. 893, datë 28.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, është vendosur rikthimi i saj në pozicionin e punës dhe marrëdhëniet financiare për këtë punonjëse kanë filluar në datën 02.03.2017.

Po kështu me urdhrin nr. 924 prot., datë 01.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm, është vendosur rikthimi i punonjësit *****, në pozicionin e tij të mëparshëm.

Për sa më sipër, rezulton se, procedura e caktimit të nëpunësit *****, në pozicionin “Përgjegjës Sektor”, është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi në caktimin e këtij punonjësi nuk janë marrë në konsideratë kategoria e pozicionit të punës, kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të vendit të punës si dhe të dhënat e nëpunësit civil, të cilit i ngarkohet detyra, në kushtet e nevojës së institucionit. Megjithatë, në momentin e kryerjes së verifikimit, rezulton se kjo paligjshmëri është rregulluar vullnetarisht nga ana e institucionit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me sa më sipër, kërkon të theksojë se, ligji për shërbimin civil ka për qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, i cili duhet të garantojë respektimin dhe zbatimin e të drejtave të nëpunësve civilë, duke krijuar kushtet për mbrojtjen e integritetit fizik, moral, si dhe të dinjitetit të tyre, sipas udhëzimeve dhe detyrave të lëna nga Komisioneri në këtë vendim. Për këtë arsye, institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit gjatë administrimit të shërbimit civil, duhet të garantojë kryerjen e të gjitha veprimeve administrative, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij,

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës” dhe 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me veprimet administrative të kryera pas datës 20.05.2016.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të nisur me vendimin nr. 1, datë 13.01.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016 dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative në fushën e administrimit të shërbimit civil të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të kryera prej datës 20.05.2016 e në vazhdim”, në lidhje me veprimet administrative të kryera pas datës 20.05.2016.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të emërimit për punonjësit *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, si akte të nxjerra në kundërshtim me nenet 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kapërcim të kompetencave si dhe në kundërshtim me procedurën ligjore.
3. Për rregullimin e paligjshmërisë, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulojë aktin e emërimit nr. 4307, datë 18.10.2016, për punonjësin ***** me detyrë “*Specialist*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 5345, datë 15.12.2016, për punonjësën ***** me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 4183, datë 12.10.2016, për punonjësën ***** me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 122, datë 11.01.2017, për punonjësin ***** me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin nr. 3783, datë 15.09.2016, për punonjësin ***** me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 1854, datë 16.05.2016, për punonjësin ***** me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 5551, datë 04.01.2017, për punonjësën ***** me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 123, datë 11.01.2017, për punonjësën ***** me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Elbasan;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 1994, datë 26.05.2016, për punonjësën ***** me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë;
- Të anulojë aktin e emërimit nr. 5389, datë 19.12.2016, për punonjësin ***** me detyrë “*Specialist*”, në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Berat;

- Të anulohet aktin e emërimit nr. 3935, datë 28.09.2016, për punonjësin ******, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë”.
4. Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurës Administrative, duhet të anulohet aktin e emërimit nr. 2458/2, datë 04.04.2016, për punonjësin ******, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë”.
 5. Pozicionet e mësipërme, të cilat konsiderohen pozicione të lira në kuptim të ligjit, duhet të plotësohen nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 6. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të transferimit (caktimit) të përkohshëm për punonjësit ******, ******, ******, ******, ******, ******, ****** dhe ******, si akte të nxjerra në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Për rregullimin e paligjshmërisë së këtyre veprimeve administrative, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulohet urdhrin e brendshëm nr. 1809, datë 11.05.2015, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ******, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë
- Të anulohet urdhrin e brendshëm nr. 6, datë 08.01.2016, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses ******, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e saj në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Korçë;
- Të anulohet urdhrin nr. 1920 prot., datë 20.05.2016, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ******, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Elbasan dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë
- Të anulohet urdhrin nr. 2457 prot., datë 22.08.2016, për transferimin e nëpunësit ******, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Durrës dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Fier;

- Të anulojë urdhrin nr. 3438 prot., datë 18.08.2016, për transferimin e nëpunësit *****, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Vlorë;
- Të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 1600 prot., datë 28.04.2016, për transferimin e nëpunësit *****, pranë Drejtorisë së Përgjithshme AKU dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Berat;
- Të anulojë urdhrin e brendshëm nr. 5 prot., datë 08.01.2016, për transferimin e nëpunësit *****, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Korçë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar, në Drejtorinë Rajonale AKU, Qarku Gjirokastrë;
- Të anulojë urdhrin nr. 1680 prot., datë 06.05.2016, për transferimin e nëpunësit *****, pranë Drejtorisë Rajonale AKU, Qarku Tiranë dhe të vendosë kthimin e tij në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të kujdeset për zhvillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm sipas kërkesave të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke mbajtur parasysh:

- a) Përcaktimin në akt të afatit (*kohëzgjatjes*) së transferimit të përkohshëm, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj, në 2 vjet.
 - b) Marrjen e miratimit nga njëسيا përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.
7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të tregojë kujdes që në të ardhmen të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rregullave ligjore për të garantuar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, duke garantuar të drejtat e nëpunësve civilë të cilët ushtrojnë detyrën në këtë institucion, nëpërmjet administrimit të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
 8. Autoriteti Kombëtar i ushqimit, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijani dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të nenit 15, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
10. Të njoftohet për këtë vendim, institucioni i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA